

**NË EMER TË POPULLIT**

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për krime të rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryetar, Have Haliti dhe Mejreme Memaj anëtar, me bashkëpunëtor profesional Shaqë Curri, si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarit R.B. nga fsh.... Komuna e ..., për shkak të veprës penale marrje e e ryshfetit nga neni 343 par.1 të KPK-së, veprës penale shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 të KPK-së, veprës penale lajmrinim i rrejshëm nga neni 306 par.1 të KPK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore- DKR në Pejë, mbrojtësit të të akuzuarit av.G.B., të paraqitura kundër aktgjyqimit e Gjykatës Themelore –DKR në Pejë P.nr. 10/2012 datë 29.05.2015, në seancën e Kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK, për të cilën janë njoftuar Prokurori i Apelit, i akuzuari, mbrojtësi i të akuzuarit dhe i dëmtuari, me 17.11.2015, morri këtë,

**A K T G J Y K I M**

I.Me aprovimin e pjesshëm të ankesës së mbrojtësit të akuzuarit R.B. av. G.B., aktgjykimi i Gjykatës Themelore - DKR në Pejë P.nr. 10/2012 datë 29.05.2015, ndryshohet përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale marrje e ryshfetit nga 343 par.1 të KPK-së, ashtu që Gjykata e Apelit gjenë se në veprimet e të akuzuarit të përshkruara nën pikën e parë të dispozitivit të aktgjyqimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale të marrjes së ryshfetit nga neni 343 par. 2 të KPK .

II.Ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit në bazat tjera ankimore refuzohen, si të pa bazuara, ndërsa aktgjykimi i ankimuar për pjesën tjetër vërtetohet .

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore –DKR në Pejë P.nr. 10/2012 datë 29.05.2015, I akuzuari R.B. është shpallur fajtor për veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 343 par.1 të KPK-së , për të cilën vepër është gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 90 ditë, si dhe dënim plotësues - ndalim I ushtrimit të profesionit si pylltar në kohëzgjatje prej një viti, në emër të paushallit gjyqësor është obliguar të paguaj shumën prej 25 euro.

I dëmtuari R.D. për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Ndërsa për veprat penale shpërdorim i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 të KPK-së dhe veprën penale lajmrinim i rrejshëm nga neni 306 par. 1 të KPK-së, është liruar nga aktakuza për shkak se nuk është provuar se i akuzuari I ka kryer këto dy vepra penale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesa kanë paraqitur, PTH-DKR në Pejë dhe mbrojtësi I të akuzuarit.

Prokuroria Themelore në Pejë, për shkak vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendje faktike, vendimit mbi sanksionin penal dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e shkallës së dytë, aktgjykimin e shkallës së parë ta ndryshoj, të akuzuarit ti shqiptoj një dënim me të ashpër me burgim dhe dënimi plotësues të jetë për kohë më të gjatë, kurse sa i për ketë pjesës lirues të shpallet fajtor dhe të dënohet konform ligjit dhe të obligoj të akuzuarin të paguaj shumën prej 4.654 euro, në emër të dobisë pasurore të fituar nga vepra penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit R.B. av. G.B., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendje faktike, dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e shkallës së dytë, aktgjykimin e shkallës së parë ta ndryshoj, ashtu që të akuzuarin ta liroj nga aktakuza ose të rikkualifikoi veprën penale nga neni 343 par.1, në nenin 343 par.2 të KPK -së. të akuzuarit ti shqiptohet dënim me kusht ose me gjobë, apo dënimi i shqiptuar ti zavendësohet me dënim me gjobë me të cilin dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Prokuroria e Apelit-DKR me shkresën PPA/I.nr.371/15 të dt. 7.09.2015 ka propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit sa i për ketë pikës se parë të dispozitivit të aktgjykimit të i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim, sa i për ketë pjesës liruese i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, kurse të refuzohet ankesa e mbrojtësit të akuzuarit R.B., av.G.B., si e pa bazuar.

Konform nenit 390 par.1dhe 4 të KPPK-së, Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit, në të cilën ishin të pranishëm, I dëmtuari, i akuzuari, mbrojtësi I tij, ndërsa nuk prezantoi Prokurori i Apelit për të cilin pati prova se ishte njoftuar me rregull. Mbrojtësi i të akuzuarit ka sqaruar disa nga pretendimet ankimore, duke shtuar se mbetet pranë pretendimeve në ankesë.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesat e Prokurorisë Themelore-DKR në Pejë, të mbrojtësit të akuzuarit av. G.B., gjeti se:

Mbrojtësi i të akuzuarit av. G.B., pretendon se aktgjykimi ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse arsyetimi i aktgjykimit nuk është në përputhje me dispozitivin, nga aryetimi nuk mund të vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet, nuk janë vërtetuar elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor.

Gjykata e Apelit ka konstatuar se aktgjykimi i ankimuar gjegjësisht, dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe i kuptueshëm. Në aktgjykimin e ankimuar nuk ka kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit. Aktgjykimi është hartuar në pajtim me dispozitat e nenit 370 par. 4, 6, 7 dhe 8 të KPRK-së, është i qartë, konkret dhe i kuptueshëm, në arsyetim janë dhënë arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë vërtetuar drejt dhe janë arsyetuar në mënyrë të plotë. Gjykata e shkallës së parë ka paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara. Gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjedhjes së çështjeve juridike dhe me rastin e vërtetimit të

ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit, si dhe rrethanat që i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit.

Në dispozitiv të aktgjykimit janë shënuar faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse i Kodit Penal, ashtu siç është paraparë në nenin 365 par. 1 nën par. 1.1 të KPPK-së.

Gjykata e Apelit gjen se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, janë të pabazuara.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, sa i për ketë pikës se parë të dispozitivit të aktgjykimit, sepse gjykata e shkallës se parë me asnjë provë nuk e ka vërtetuar një datë, se kur i dëmtuari i ka dhënë të hollat të akuzuarit, që të mirret si datë e kryerjes se veprës penale, kurse është akuzuar se ketë veprë penale e ka kryer në vazhdimësi nga pranvera e vitit 2009 deri në maj të vitit 2011, duke mos dhënë asnjë provë, se i akuzuari R.B. në cilin vend dhe në cilën kohë i ka marrë të hollat.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e mësipërme ankimore të mbrojtësit të akuzuarit nuk janë të bazuara.

Se Gjykata e shkallës se parë nga dëshmitë e të dëmtuarit R.D. dhe dëshmitarëve M. dhe S. S. dhe N. H., drejtë ka vërtetuar, se i akuzuari në cilësi të rojës se pyellit ka marrë të holla nga i dëmtuari R.D., për mos me e denoncua për prerjen ilegale të pyellit, ashtu që i akuzuari nga 26.06.2009 e deri në maj të vitit 2011 në cilësinë e personit përgjegjës –pylltar i DPBH-në Istog, nga i dëmtuari R.D. në vazhdimësi ka marrë të holla për të mos ushtruar denoncim penal kundër tij për prerjen ilegale të pyellit, në ketë drejtim Gjykata e shkallës se parë drejtë ka vërtetuar gjendje faktike, e cila është e pranueshme edhe për ketë Gjykatë, se ky fakt është vërtetuar edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve tjerë të dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe të dëshmitarit N.H. i cili ka deklaruar se në prezencën e tij i dëmtuari R. ja ka dhënë 200 euro të akuzuarit R.B.. Prandaj nuk është kontestuese se i akuzuari R.B. ka qenë në shtëpinë e të dëmtuarit R.D. dhe në prezencën e dëshmitarit N.H., i dëmtuari R. ja ka dhënë 200 euro. Lidhur me këtë rrethanë është dhënë arsyetimi në aktgjykimin e ankimuar në faqen e 7 parafi i tretë.

Nga arsyet që u thanë më lartë, kjo gjykatë gjen se janë të pabazuara pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se në aktgjykimin e ankimuar gjendja faktike është vërtetuar jo e plotë dhe e gabuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit pretendon se është shkelur ligji penale në dëm të akuzuarit, sepse dispozitivi i aktgjykimit përmban elemente të veprës penale të marrjes se ryshfetit nga neni 343 par.2 të KPK, i akuzuari akuzohet për veprimin që është dashur të kryej, e jo sipas nenit 343 par.1 të KPK .

Gjykata e Apelit duke vlerësuar pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit, gjënë se ankesa mbrojtësit të akuzuarit është e bazuar, se Gjykata e shkallës e parë e ka shkelur ligjin penal, kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale nga neni 343 par.1 të KPK-së, se nga vlerësimi i shkresave të lëndës, kjo gjykatë ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet e veprës penale nga neni 343 par 2 të

KPK, se në cilësi të personit zyrtar në kuadër të autorizimeve të tij, ka pranuar të holla të mos e kryej një veprim zyrtar të cilin është dashur ta kryej, si person zyrtar, të paraqes fletëparaqitje penale ndaj R.D., i cili ka dëmtuar pyellin shtetëror .

Prandaj për këto arsye, Gjykata e Apelit ka ndryshuar ashtgjakimin e shkallës së parë, përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale, mëqë gabimisht është aplikuar ligji penal në dëm të akuzuarit.

Pretendimet e Prokurorisë se dënimi i shqiptuar është i butë dhe pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se dënimi i shqiptuar është i ashpër, janë të pa bazuara .

Pretendimet ankimore të Prokuroria Themelore në Pejë, se Gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat, me rastin e shqiptimit të dënimit, si mënyrën e kryerjes së veprës penale, dëmin e shkaktuar pasurisë së shtetit, dënimi i shqiptuar me burgim nga gjykata e shkallës së parë dhe dënimi plotësues që vetëm një vit të ndalohet ushtrimi i profesionit, janë dënime të ulëta, me të cilat nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit, kurse të personat tjerë përcjellë mesazh të kundërt.

Ndërsa mbrojtësit të akuzuarit, ka kërkuar që i akuzuari të lirohet nga akuza ose të shqiptohet dënim me kusht. Por nuk thekson ndonjë rrethanë konkrete e cila kishte me ndikuar që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i butë nga ai i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë.

Kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë me rastin e përcaktimit të dënimit ka pasur parasysh rrethanat që kanë dikuar në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethana lehtësuese ka marrë, sjelljen e të akuzuarit para dhe pas kryerjes së veprës penale, se më parë nuk ishte i dënuar, gjendjen ekonomike, se është mbajtës i familjes shumë anëtarësh, kurse rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Prokuroria në ankesë nuk thekson rrethana konkrete rënduese të cilat kishin me ndikuar në ashpërsimin e dënimit, ndërsa mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë nuk thekson rrethana konkrete lehtësuese të cilat kishin me ndikuar në zbutjen e dënimit, përveç atyre që janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë si rrethana lehtësuese, të cilat rrethana lehtësuese në terësi i aprovon edhe kjo gjykatë, prandaj kjo gjykatë gjen se pretendimet e prokurorisë në ankesë se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është i butë dhe pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se dënimi i shqiptuar është i ashpër janë të pa bazuara, sipas gjetjeve të kësaj gjykate, dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është në proporcion me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, andaj ka bërë ri-cilësimin juridik të veprës penale në vepër më të lehtë si në dispozitiv të aktgjykimt, se dënimi i shqiptuar është drejtë në proporcion me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, e sipas bindjes edhe të kësaj gjykate me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit në terësi do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK .

Sa i për ketë pjesë liruese të aktgjykimt, gjykata e shkallës së parë nuk ka gjetur prova se i akuzuari ka kryer veprat penale shpërdorim i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 të KPK-së dhe veprën penale lajmërim i rrejshëm nga neni 306 par. 1 të KPK-së, andaj të akuzuarin me të drejtë e ka liruar nga këto dy pika të aktakuzës, në mungesë të provave.

Pretendimet ankimore të paraqitur nga PTH në Pejë lidhur me pjesën liruese të aktgjykimit, janë të pa bazara.

Prokuroria Themelore –DKR në Pejë, sa i për ketë pjesë liruese të aktgjykimit të pikës së II dhe III të, propozon që i akuzuari për veprën penale shpërdorim i detyrës zyrtare nga neni 339 Par.3të KPK-së dhe veprën penale lajmërim i rrejshëm nga neni 306 par.1 të KPK –së të shpallet fajtor . Kjo për faktin se gjykata nuk i ka marrë për baze deklaratën e të dëmtuarit, i cili i ka prerë 6 trupa në pyellin shtetëror me vëllim prej 3042m<sup>3</sup>, vlera e të cilave ka qenë 5000 euro, për të akuzuarin R.B., në vendin e quajtur “ NN” në bjeshkët e Komunës së... , kurse i akuzuari për ti mbuluar veprimet e tij, e ka denoncuar të dëmtuarin R. disa herë, kinse ka prerë dru në periudha të ndryshme, për çka i dëmtuari R. e ka denoncuar të akuzuarin R. në Prokurori për vepër penale marrje rryshfetit. Sipas prokurorisë pika e II dhe e III e aktakuzës ka qenë e lidhur në mënyrë kontinuele me pikën e I të aktakuzës, si pjesë e marrëveshjes në mes të akuzuarit R. dhe të dëmtuarit R..

Gjykata e Apelit nga arsyet që u cekura më lartë, gjen se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike për të dy pikat liruese të aktgjykimit të ankimuar, duke u mbështetur në deklaratën e të dëmtuarit R.D., i cili ka deklaruar se nuk e mban mend datën e saktë, por e din se në vitin 2011 për llogari të akuzuarit ka prerë 6 trungje dru të breut, se ka vendosur të lajmëroj rastin në prokurori, se pylltari tani i akuzuarit R. i ka bërë fletë paraqitje për këto trungje, kurse prokurori nuk e ka provuar me asnjë provë ditën, vendin kur janë prerë drutë dhe ku kush i ka marrë ,të cilës dëshmi gjykata e shkallës së parë nuk ja ka falur besimin, sepse i dëmtuari ka qenë i dyshuar për këto trungje, i është bërë fletëparaqitja penale, e cila është vërtetuar nga ditari pyjor i pylltarit-tani të akuzuarit, e cila u administruar si provë në shqyrtimin gjyqësor, se ndaj të dëmtuarit është ngritur aktakuza për ketë vepër penale, si dhe vepra tjera penale.

Kurse sa i për ketë pikë të tretë të pjesës liruese të aktgjykimit, te datës 30.06.2011, edhe kjo vepër penale nuk është vërtetuar se është kryer nga i akuzuari sepse i njëjti në kuadër të autorizimeve të tij zyrtare ka ushtruar disa fletëparaqitje penale kundër të dëmtuarit R.D., mbi bazën e të cilave është ngritur aktakuza, ashtu që Prokuroria gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka argumentuar akuzën për veprën penale lajmërim i rrejshëm, siç e ka akuzuar të akuzuarin.

Gjykata e Apelit e mbështet gjykatën e shkallës së drejtë ka vepruar kur të akuzuarin e ka liruar nga kjo pikë e akuzës

Pretendimet për shkeljen e Ligjit Penal dhe gjetjet e gjykatës .

Prokuroria në ankesë pretendon se vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike gabimisht ka sjellë deri te aplikimi i së drejtës materiale me marrjen e aktgjykimit lirues dhe gjykata gabimisht ka aplikuar te drejtën materiale kur të akuzuarin e ka liruar nga akuza.

Pretendimet e prokurorisë në anekse se gjykata e shkallës së parë në mënyrë jo të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, janë pretendime të pabazuara.

Si është thënë më lartë gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë e aprovon dhe kjo gjykatë, meqenëse me provat e administruara nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer

veprat penale për të cilën është akuzuar, gjykata të akuzuarin R.B., e ka liruar nga akuza, prandaj gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar ligjin penal kur të akuzuarin e ka liruar nga akuza , meqenëse me provat e administruara nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën është akuzuar prandaj me të drejtë të akuzuarin R.B. e ka liruar nga akuza.

Nga çka u tha më lartë , u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit në bazë të nenit 401 dhe nenit 403 të KPPK-së.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

**PAKR.nr. 392/2015 me 17.11.2015**

**Procesmbajtësi,**

**Anëtarët e kolegjit**

**Kryetari i kolegjit**

\_\_\_\_\_

**Shaqë Curri**

\_\_\_\_\_

**Have Haliti**

\_\_\_\_\_

**Xhevdet Abazi**

\_\_\_\_\_

**Mejreme Memaj**